



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

RAPORTI VJETOR 2024





QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

RAPORTI VJETOR

2024

RAPORTI I AKTIVITETEVE
TË ZHVILLUARA DHE
PASQYRA FINANCIARE

PËRMBAJTJA

1. QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN	7
1.1. MISIONI	7
1.2. VIZIONI	7
1.3. DETYRAT	7
2. STRUKTURA	8
2.1. DREJTORI	8
2.2. KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN	8
2.3. KËSHILLI KOORDINUES I ARSIMTAREVE NË DIASPORË	9
2.4. STRUKTURA ADMINISTRATIVE	10
3. SEKTORIT I BOTIMIT, KOORDINIMIT DHE SHPËRNDARJES	14
3.1. SIGURIMI DHE SHPËRNDARJA E TEKSTEVE MËSIMORE NË DIASPORË PËR VITIN SHKOLLOR 2024–2025, NË KOORDINIM ME MINISTRINË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME	14
3.2. PËRDITËSIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE TË SHKOLLAVE/ KURSEVE DHE MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË	17
3.3. BOTIME	19
– <i>Botimi i librave dygjuhësh</i>	19
– <i>Redaktime, dizajne dhe veprimtari të përditshme pune</i>	23
– <i>Botime informuese (Libri “Seminarit XVII Mbarëkombëtar për mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë. Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë”</i>	23
4. SEKTORI I DIGJITIMIT, KOMUNIKIMIT DHE PROJEKTEVE	26
4.1. PROJEKTE	26
– <i>Projekti i BE-së – Rezidenca e përkthyesve “Fan Noli”</i>	26
– <i>Revista informuese periodike “Flasim shqip”</i>	29
– <i>Shkolla verore “Jam shqiptar”, organizimi i vitit 2024</i>	31
4.2. AKTIVITETE	34
– <i>Organizimi i seminarit me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Mynih të Gjermanisë, në datat 9-10 mars 2024</i>	34
– <i>Pjesëmarrje në panairin e librit “Leipzig 2024”, në datat 21-24 mars</i>	34
– <i>Organizimi i trajnimit me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Bolonja të Italisë, më 7 prill 2024</i>	35
– <i>Pjesëmarrje në Panairin e 3-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, në Tiranë, në datat 23-25 prill 2024</i>	36

– Zhvillimi i takimeve online me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë me temë: “Plane dhe projekte për mësimdhënien në diasporë për vitin 2024”	37
– Takim në Universitetin “Luigj Gurakuqi” me temë: “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare në diasporë”, 14 qershor 2024	38
– Seminari XVII mbarëkombëtar me temë “Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”, në Prishtinë, në datat 18-21 korrik 2024	39
– Pjesë e grupit të punës për organizimin e Kuvendit Kombëtar për Gjuhës Shqipe, në Tiranë, në datat 21-22 nëntor 2024	40
– Organizimi i trajnimit me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Athinë të Greqisë, 15 dhjetor 2024	42
4.3. VEPRIMTARI TË TJERA	43
– Komunikimi	43
– Menaxhimi i rrjeteve sociale të institucionit	43
– Përditësimi i portalit	43
– Dizajni dhe digjitimi	43
– Përditësimi i Programit të Trasparencës	44
4.4. PREZANTIMI DHE PROMOVIMI I PUNËS SË QBD-SË	44
5. KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN	46
6. KËSHILLI KOORDINUES I ARSIMTARËVE TË DIASPORËS	48
7. BASHKËPUNIME ME INSTITUCIONE BRENDË DHE JASHTË VENDIT	50
7.1. BASHKËPUNIME TË QBD-SË ME INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN DHE DIASPORËN NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË	50
a) Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore të Përbashkëta për Diasporën	50
b) Koordinimi dhe ndjekja e punës së grupit ndërinstitutional të punës Shqipëri–Kosovë për organizimin e Seminarit XVII Mbarëkombëtar për mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë	51
8. SEKTORIT I FINANCËS DHE SHPËRBIMEVE MBËSHTETËSE	54
8.1. BUXHETI I AKORDUAR PËR VITIN 2024	54
8.2. BUXHETI I REALIZUAR PËR VITIN 2024	55
PLANI I PUNËS 2025	60
SHTOJCA	65
– VENDIME TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS	66
– VENDIME TË KËSHILLIT KOORDINUES TË BOTIMEVE PËR DIASPORËN	71

1. QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD) është institucion i krijuar me VKM-në nr. 469, datë 26.07.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, të ndryshuar, që financohet nga buxheti i shtetit dhe është në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin.

1.1. MISIONI

Qendra e Botimeve për Diasporën ka për mision:

- Mbështetjen e mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë përmes botimit, sigurimit të teksteve mësimore dhe materialeve plotësuese;
- Njohjen dhe përhapjen e kulturës kombëtare në diasporë përmes botimit të teksteve shkolllore, botimit të librave me përmbajtje letrare, historike dhe sociale;
- Organizimin dhe mbështetjen e veprimtarive edukative, kulturore dhe sociale, që kanë për qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe dhe kulturës amtare në diasporë.

1.2. VIZIONI

Qendra është në shërbim të misionit të ministrit përgjegjës për arsimin në përfaqësimin dhe nxitjen e politikave të bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, me qëllim fuqizimin dhe bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë.

1.3. DETYRAT

Detyrat e Qendrës së Botimeve për Diasporën janë:

- Botimi i teksteve mësimore dhe materialeve plotësuese, që do t’i shërbejnë mësimdhënies dhe ruajtjes së identitetit kombëtar në komunitetet shqiptare të diasporës.
- Redaktimi përfundimtar i teksteve dhe materialeve plotësuese që do të botohen.
- Nxitja e aksesit *on-line* dhe teksteve të veçanta për diasporën.

- Nxitja e krijimit të platformave digjitale të mësimdhënies dhe të formateve të posaçme për e-book.
- Përgatitja dhe zbatimi i projekteve dhe programeve për mësimin e gjuhës shqipe në distancë nëpërmjet internetit si dhe rrjeteve e kanaleve elektronike të komunikimit masiv.
- Sigurimi i teksteve mësimore për diasporën, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara.
- Zhvillimi dhe ruajtja e identitetit kombëtar përmes mësimin të gjuhës, kulturës së prejardhjes, si dhe njohjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore kombëtare.
- Organizimi dhe mbështetja e veprimtarive dhe projekteve në ndihmë të përhapjes së gjuhës dhe kulturës amtare në diasporë.
- Mbulimi i shpenzimeve për shpërndarjen e teksteve mësimore e të materialeve plotësuese deri në misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.

2. STRUKTURA

Në përputhje me pikën 6, 8 dhe 8/1 të VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”, të ndryshuar, Qendra e Botimeve për Diasporën drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori. Pranë QBD-së funksionojnë: Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si organ vendimmarrës për çështjet e botimeve dhe aktiviteteve për diasporën, dhe Këshilli Koordinues i Arsimitarëve të Diasporës, si organ këshillimor për çështjet e mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.

2.1. DREJTORI

Drejtori i Qendrës së Botimeve për Diasporën është autoriteti përgjegjës i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e Qendrës.

Drejtori e përfaqëson QBD-në në marrëdhënie me të tretët. Ai emërohet në detyrë nga ministri përgjegjës për arsimin. Qysh prej krijimit të QBD-së këtë detyrë e ka ushtruar znj. Mimoza Hysa Çuliqi.

Drejtori raporton dhe përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për aktivitetin e QBD-së në mënyrë periodike.

2.2. KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Bazuar në VKM-në nr. 469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”, të ndryshuar, pranë QBD-së funksionon Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si organ vendimmarrës për çështjet e botimeve dhe aktiviteteve për diasporën.

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën është organ kolegjal, i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, i cili ka përfaqësues nga:

- a) ministria përgjegjëse për arsimin, dy anëtarë;
- b) ministria përgjegjëse për punët e jashtme, një anëtar;
- c) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, një anëtar;
- d) Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, një anëtar.

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën ka këto kompetenca:

- a) Shqyrton kërkesat për botime për diasporën.
- b) Miraton programet e botimeve të QBD-së, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me diasporën.
- c) Shqyrton dhe miraton propozimet e QBD-së për botimin e teksteve të tjera e të materialeve plotësuese për diasporën, të cilat i njoftohen ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- ç) Shqyrton dhe miraton propozimet e QBD-së për përcaktimin e kostove të teksteve e të materialeve plotësuese për diasporën, të cilat i njoftohen ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- d) Planifikon shpërndarjen e teksteve e të materialeve plotësuese të botuara nga QBD-ja.
- dh) Merr vendime për çështje të tjera, që lidhen me veprimtarinë e QBD-së.

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën është i përbërë nga:

- Znj. Voltisa Bleta, Ministria e Arsimit dhe Sportit (kryetare);
Znj. Anila Ferizaj, Ministria e Arsimit dhe Sportit (anëtare);
Znj. Enkeleda Riza, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (anëtare);
Znj. Evalda Paci, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (anëtare);
Znj. Brunilda Spahiu, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë (anëtare).

2.3. KËSHILLI KOORDINUES I ARSIMTARËVE NË DIASPORË

Bazuar në VKM-në nr. 469, datë 26.07.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, të ndryshuar, pranë QBD-së funksionon Këshilli Koordinues i Arsimtarëve në Diasporë, si organ këshillimor për çështjet e mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.

Këshilli Koordinues i Arsimtarëve në Diasporë (KKAD) e nisi punën më 1 shkurt të vitit 2021. Ky Këshill ka për qëllim të japë informacionet e nevojshme të lidhura me çështjet e arsimit, si dhe propozime konkrete të lidhura me to.

Këshilli Koordinues i Arsimtarëve në Diasporë është organ kolegjal, i përbërë nga 10 (dhjetë) anëtarë, të cilët përzgjidhen nga radhët e mësuesve me origjinë shqiptare që punojnë në diasporë, organizatorë të zhvillimit të mësimin të gjuhës shqipe në diasporë.

Këshilli Koordinues i Arsimtarëve në Diasporë është i përbërë nga:

- | | |
|--------------------------------|----------|
| Z. Mustafë Krasniqi (Gjermani) | Kryetar; |
| Znj. Mira Hasa Shehu (Kanada) | Anëtare; |
| Znj. Teuta Tabaku (Turqi) | Anëtare; |

Znj. Aurela Konduri (Greqi)	Anëtare;
Znj. Anila Kadija (Mbretëri e Bashkuar)	Anëtare;
Z. Dritan Mashi (Itali)	Anëtar;
Z. Isuf Bytyçi (Gjermani)	Anëtar;
Znj. Miradije Berisha (Austri)	Anëtare;
Znj. Anita Duriçi (Zvicër)	Anëtare;
Znj. Arta Emiri (Suedi)	Anëtare.


Misioni i KKAD-së është bashkimi i forcave arsimore dhe shkencore në diasporë dhe së bashku me institucionet të realizojë zgjidhjen e kërkesave të problemeve kyçe në unifikimin e shkollave shqipe në diasporë, pasi shkollat kanë për qëllim mbrojtjen e gjuhës dhe të identitetit kombëtar, të mbështetura në baza të forta didaktike, gjuhësore dhe shkencore me moton “*Një gjuhë, një komb*”, që duhet të jetë unike për të gjitha shkollat shqipe.

Vizioni i KKAD-së është sensibilizimi i gjithë faktorëve kombëtarë (prindërit, shoqatat dhe institucionet shtetërore) që sa më parë të arrijmë në një platformë kombëtare, për një shkollë shqipe kombëtare, të unifikuar dhe funksionale.

2.4. STRUKTURA ADMINISTRATIVE

Struktura e Qendrës së Botimeve për Diasporën është miratuar me urdhrin nr. 76, datë 15.04.2019, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën*”, të Kryeministrit, ndryshuar me urdhrin nr. 220, datë 1.11.2024, “*Për një ndryshim në urdhrin nr. 76, datë 15.04.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën*”, të Kryeministrit. Sipas kësaj strukture të miratuar, QBD-ja është e përbërë nga 3 (tre) sektorë dhe një personel prej 15 (pesëmbëdhjetë) punonjësish.

Struktura dhe organika e QBD-së është sipas tabelës së mëposhtme:



Sipas organizimit strukturor të miratuar, QBD-ja përbëhet nga 3 sektorë:

- Sektori i Digjitimit, Komunikimit dhe Projekteve;
- Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes;
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

► **Sektori i Digjitimit, Komunikimit dhe Projekteve**, ndër të tjera, është përgjegjës për:

- krijimin, hartimin, përditësimin, pasurimin dhe publikimin e të dhënave dhe librave elektronik në kohë reale në faqen zyrtare të institucionit;
- vendosjen dhe mbajtjen e lidhjeve me shoqatat, organizatat, qendrat, përfaqësitë brenda dhe jashtë vendit, të cilat kanë diasporën si objekt të veprimtarisë të tyre;
- grumbullin e informacione apo të dhënave nga shkollat e gjuhës shqipe dhe shoqatat në diasporë për efekte statistikore dhe informimi;
- përgatitjen e faqosjes së librave në formatin për botim dhe formatin e librit elektronik (e-book);
- përgatitjen e përmbajtjes së lajmeve, të komunikimit me publikun në shërbim të QBD-së;
- grumbullimin e informacionit të plotë për thirrjet e projekteve dhe përgatitjen e dosjeve e aplikimit për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
- hartimin dhe ndjekjen e projekteve të QBD-së.

► **Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes**, ndër të tjera, është përgjegjës për:

- Botimin e materialeve mësimore dhe plotësuese për diasporën;
- ndjekjen e punës së grupit të punës ndërinstitucional për miratimin e teksteve mësimore për diasporën;
- koordinimin e punës për ndjekjen dhe sigurimin e shpërndarjes së teksteve mësimore dhe materialeve plotësuese sipas kërkesave të diasporës;
- bashkërendimin e punës për shpërndarjen e teksteve mësimore për diasporën, si dhe të botimeve të tjera që janë objekt i punës së QBD-së;
- hartimin e një bazë të dhënash duke mbajtur lidhje me shkollave, qendrat mësimore, shoqatat, mësuesit dhe individë të ndryshëm në diasporë të interesuar për pajisjen me tekste mësimore.

► **Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**, ndër të tjera, është përgjegjës për:

- kryerjen e të gjitha veprimtarive mbështetëse të QBD-së me qëllim plotësimin e misionit të saj;
- përgatitjen e projektbuxhetit vjetor dhe atij afatmesëm të QBD-së si dhe bashkërendimin e punës me strukturat e tjera gjatë gjithë procesit në zbatim të legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe raportimin e problematikave të ndryshme që dalin gjatë zbatimit të tij;

- zhvillimin, përgatitjen dhe zbatimin në përputhje të plotë me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik të të gjitha procedurave të prokurimit dhe ndjekjen e zbatimit të kontratave për prokurimet;
- menaxhimin e problemeve, çështjeve juridike që lidhen me institucionin;
- konceptimin e të gjitha akteve administrative dhe shkresave të ndryshme që nxirren nga QBD-ja në përputhje me ligjin.



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

RAPORTI VJETOR

2024

SEKTORI I BOTIMIT,
KOORDINIMIT DHE
SHPËRNDARJES

3. SEKTORI I BOTIMIT, KOORDINIMIT DHE SHPËRNDARJES

3.1. SIGURIMI DHE SHPËRNDARJA E TEKSTEVE MËSIMORE NË DIASPORË PËR VITIN SHKOLLOR 2024–2025, NË KOORDINIM ME MINISTRINË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Referuar pikës nr. 5/1, 5/2 dhe 5/3 të VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, e ndryshuar; Urdhrit të Përbashkët nr. 4801 Prot., datë 8.9.2021, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, nr. 4184 Prot., datë 7.09.2021, të Ministrit të Shtetit për Diasporën, dhe nr. 01B/294 Prot., datë 29.09.2021, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, “Për miratimin e tekstit mësimor për diasporën ‘Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare’, niveli I”; Urdhrit/Vendimit të Përbashkët nr. 918 Prot., datë 02.02.2024, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, nr. 01B/023 Prot., datë 11.03.2024, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, “Për miratimin e tekstit mësimor për diasporën ‘Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare’, niveli II”; Vendimit nr. 3, datë 01.07.2024, të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën “Për miratimin e listës së teksteve shkollore për mësimin plotësues në diasporë për vitin shkollor 2024–2025”; shkresës së ardhur nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën, me nr. 7781 Prot., datë 17.05.2024, “Përcillet kërkesa për tekste për vitin shkollor 2024–2025”, protokolluar me tonën me nr. 81 Prot., datë 21.05.2024; Vendimit nr. 4, datë 04.09.2024, të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën “Për miratimin e pjesshëm të listës së 480 teksteve mësimore/shkollore për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në SHBA, Australi, Kanada dhe Japoni për vitin shkollor 2024–2025”; si dhe shkresës së ardhur nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në SHBA drejtuar MEPJ-së me nr. 190/1/24 Prot., datë 22.08.2024, “Përcillet kërkesa për pajisjen me tekste fizike për SHBA për vitin shkollor 2024–2025”, është organizuar puna për sigurimin dhe shpërndarjen e teksteve mësimore “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli I, si dhe “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli II, për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë për vitin shkollor 2024–2025 prej **15 890** tekstesh gjithsej sipas destinacioneve.

Theksojmë se shpërndarja e teksteve mësimore në destinacionet përkatëse u bë me shpenzimet e QBD-së pas një takimi të organizuar midis përfaqësuesve të Qendrës së Botimeve për Diasporën

dhe përfaqësuesve të Postës Shqiptare, ku u diskutua rreth organizimit të punës së shpërndarjes, si dhe u mor informacioni i domosdoshëm rreth tarifave dhe procedurave të nevojshme.

Në mjediset e Qendrës së Botimeve për Diasporën u realizua numërimi dhe sistemimi i teksteve në pako të veçanta diplomatike për çdo destinacion sipas shtetit përkatës, si dhe pakot u pajisën me dokumentacionin e nevojshëm nga përfaqësues të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për t'u dërguar me kargo diplomatike në përfaqësitë e caktuara diplomatike.

Po ashtu është mbajtur korrespondencë e vazhdueshme me Postën Shqiptare për mbarëvajtjen e procesit të shpërndarjes së teksteve mësimore të mësipërme dhe në përshpejtimin e këtij procesi.

Tabela. Shpërndarja e teksteve sipas shteteve

Nr.	Shteti	Numri i pakova dhe teksteve fizike Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare, Niveli I	Numri i pakova dhe teksteve fizike Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare, Niveli II	Totali i përgjithshëm i teksteve fizike (Niveli I + Niveli II)
1.	Gjermani	350 x 4 = 1400	650 x 2 = 1300	2700
2.	Greqi	480 x 4 = 1920	455 x 2 = 910	2830
3.	Itali	480 x 4 = 1920	370 x 2 = 740	2660
4.	Zvicër	190 x 4 = 760	330 x 2 = 660	1420
5.	Danimarkë	120 x 4 = 480	–	480
6.	Izrael	60 x 4 = 240	–	240
7.	Rumani	15 x 4 = 60	5 x 2 = 10	70
8.	Slloveni	80 x 4 = 320	80 x 2 = 160	480
9.	Austri	30 x 4 = 120	40 x 2 = 80	200
10.	Belgjikë	50 x 4 = 200	50 x 2 = 100	300
11.	Suedi	–	150 x 2 = 300	300
12.	Turqi	110 x 4 = 440	110 x 2 = 220	660
13.	Angli	250 x 4 = 1000	250 x 2 = 500	1500
14.	Kroaci	45 x 4 = 180	30 x 2 = 60	240
15.	SHBA	350 x 4 = 1400	–	1400
16.	Kanada	–	55 x 2 = 110	110
17.	Australi	65 x 4 = 260	–	260
18.	Japoni	10 x 4 = 40	–	40
		2685 pako x 4 tekste/pako = 10 740 tekste	2575 pako x 2 tekste/pako = 5150 tekste	15 890 tekste

Shënim. Janë shpërndarë falas edhe **tekste plotësuese:** në Australi 50 copë, në Kanada 50 copë.

Kështu, teksti *“Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”*, Niveli I, dhe *“Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”*, Niveli II, u shpërnda falas për nxënësit që mësojnë gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare në diasporë në 18 shtete, përkatësisht në Gjermani, Greqi, Itali, Zvicër, Danimarkë, Izrael, Rumani, Slloveni, Austri, Belgjikë, Suedi, Turqi, Angli, Kroaci, SHBA, Kanada, Australi, Japoni.



Harta e shpërndarjes së teksteve “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli I, dhe “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli II, sipas shteteve



3.2. PËRDITËSIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE TË SHKOLLAVE/ KURSEVE DHE MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË

Në përmbushje të detyrës së koordinimit dhe shpërndarjes së teksteve mësimore, Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes ka vijuar punën me përditësimin e bazës së të dhënave të shkollave/ kurseve dhe mësuesve të gjuhës shqipe në diasporë, të krijuar që në vitin e parë të punës.

Në databazën e QBD-së tashmë janë të regjistruar **804 kontakte mësuesish**, rreth **410 shkolla/kurse** të mësimit shqip në diasporë dhe **393 shoqata shqiptare**.

Numri i mësuesve, pjesë e Regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe në diasporë, arriti në 90.

Përditësimi i të dhënave për prezantimin e vendndodhjes së shkollave shqipe në diasporë pasqyrohet edhe në hartën digjitale në portalin zyrtar të Qendrës së Botimeve për Diasporën.



3.3. BOTIME

► *Botimi i librave dygjuhësh*

Në vijimësi të programit të librave dygjuhësh, pas përmbylljes me sukses të projekteve të botimeve dygjuhësore, si: **“Tregime të moçme shqiptare”** me autor Mitrush Kutelin (në 5 gjuhë krahas shqipes, si: *anglisht, frëngjisht, greqisht, italisht, gjermanisht*); **Fjalori dygjuhësh për fëmijë** (në 9 gjuhë krahas shqipes, si: *frëngjisht, anglisht, italisht, greqisht, gjermanisht, spanjisht, ukrainisht, rumanisht, kroatisht*); **Seria “Klasikët dygjuhësh”** (7 libra, me nga 2 përralla klasike për çdo libër, në 3 gjuhë krahas shqipes, si: *anglisht, greqisht, italisht*); si dhe në kuadër të ruajtjes, zhvillimit dhe mësimin të gjuhës shqipe në diasporë, gjatë vitit 2024, Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes ka vijuar punën me 2 projekte të tjera (afatgjata) të miratuara në fund të vitit 2022, që synojnë edhe këto pasurimin e fjalorit të lexuesve të diasporës me fjalë të reja në gjuhën shqipe, si dhe zotërimin dhe përdorimin e dy gjuhëve në të njëjtën kohë.



Këto projekte janë *“Jam shqiptar”* dhe *“Botimi dygjuhësh i vëllimit me poezi të zgjedhura nga krijimtaria e shkrimtarit Dritëro Agolli”*.

- **Projekti “Jam shqiptar”** është konceptuar si një cikël me materiale didaktike për mësimdhënien në diasporë, me udhërrëfyes të trashëgimisë kulturore për 10 qytete të Shqipërisë dhe Kosovës, si: *Tirana, Durrësi, Shkodra, Berati, Gjirokastra, Kruja, Vlora, Prishtina, Prizreni, Gjakova*, me ilustrime dhe i përshtatur për fëmijë, për t’u shërbyer fëmijëve të diasporës që të njohin më nga afër Shqipërinë dhe Kosovën.

Projekti është miratuar me Vendim të KKBD-së nr. 4, datë 02.09.2022.

Me këtë cikël udhërrëfyesish synohet marrja e njohurive rreth historisë dhe gjeografisë së qyteteve, trashëgimisë kulturore shqiptare, figurave të shquara, ku fëmijë dhe të rritur do të përfshihen në zbulimin dhe rizbulimin e trashëgimisë kulturore shqiptare; do të afrohen më tepër me gjuhën shqipe, fjalorin dhe me pasurinë tonë trashëgimore; do t'u kultivohet ndjenja e krenarisë për identitetin kombëtar shqiptar në diasporë.

Autore e udhërrëfyesve është znj. Milena Selimi, ilustrator/ piktor z. Bertrand Shijaku dhe redaktor shkencor Dr. Rigels Halili.

Përgjatë vitit 2024 -në vijim të punës së bërë gjatë vitit 2023 me përgatitjen e udhërrëfyesve për 3 (tre) qytete, si: *Gjirokastra, Shkodra, Berati*- ka përfunduar përgatitja, redaktimi, skanimi i fotove, mbajtja e kontakteve me grupin e punës (autor-ilustrator), si dhe kontrolli përfundimtar (pas faqesjes) i 3 (tre) udhërrëfyesve të tjerë të trashëgimisë kulturore, si: *Prizreni, Prishtina, Gjakova*, të publikuar edhe këta online në faqen zyrtare të QBD-së.





- **Projekti “Botimi dygjuhësh i vëllimit me poezi të zgjedhura nga krijimtaria e shkrimtarit Dritëro Agolli në shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht, shqip-frëngjisht”** do të shërbejë si tekst ndihmës për shkollat në diasporë, me qëllim zgjerimin e njohurive të nxënësve mbi gjuhën shqipe dhe si tingëllon ajo jo vetëm në prozë, por edhe në poezi, si dhe njihjen e një prej shkrimtarëve më në zë të letërsisë shqiptare, Dritëro Agollin.

Projekti është miratuar me Vendim të KKBD-së nr. 6, datë 27.10.2022.

Botimi dygjuhësh i këtij vëllimi me poezi të zgjedhura për fëmijë e të rritur, nisur edhe nga kurrikula e përbashkët e mësimi plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë, do të shërbejë si material ndihmës për shkollat në diasporë, me qëllim zgjerimin e njohurive të tyre mbi gjuhën shqipe; do të nxitet dygjuhësia, duke përqasur gjuhën amtare me gjuhën e vendit pritës; fëmijëve dhe të rriturve në diasporë do t'u mundësohet thellimi i njohurive për gjuhën dhe për kulturën shqiptare; do ta njohë brezin e ri të diasporës edhe me një prej shkrimtarëve më në zë të letërsisë shqiptare, Dritëro Agollin, si dhe do t'u kultivojë atyre ndjenjën e krenarisë për identitetin kombëtar shqiptar në diasporë.



Gjatë këtij viti përfundoi përkthimi letrar i 50 poezive të para të Dritëro Agollit nga gjuha shqipe në gjuhët: *anglisht* (nga znj. Manjola Nasi), *italisht* (nga znj. Griselda Doka), *greqisht* (nga znj. Eleana Zhako), *gjermanisht* (nga znj. Loreta Schillock) dhe *frëngjisht* (nga bashkëpërkthyesit znj. Evelyne Noygues dhe z. Alexandre Zotos).




Gjithashtu u bë marrja në dorëzim e materialeve të redaktuara nga redaktorët shkencorë, u krye dizajni i botimit dygjuhësh të 50 poezive të para të **“Përmbledhje me poezi” të Dritëro Agollit** në *shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht, shqip-frëngjisht*, si dhe u realizuan kopertinat përkatëse.

Në vijim të punës me këtë projekt, vlen të përmendet edhe bashkëpunimi ndërmjet përkthyesve letrarë të poezive të Dritëro Agollit me redaktorët shkencorë dhe sektorin e botimit në kuadër të nismës që ndërmori Qendra e Botimeve për Diasporën me ngritjen e Rezidencës “Fan Noli”, e para rezidencë për përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj, pjesë e projektit “Kultura lëviz Evropën”, zbatuar nga Instituti “Gëte”.

Redaktime, dizajne dhe veprimtari të përditshme pune

Përgjatë këtij viti, në Sektorin e Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes janë kryer edhe punë të tjera, si:

- Redaktimi i të gjitha materialeve të **Revistës informuese “Flasim Shqip”, numri 2;**
- Redaktimi i të gjitha materialeve të **Revistës informuese “Flasim Shqip”, numri 3;**
- Redaktimi i të gjitha materialeve të **Revistës informuese “Flasim Shqip”, numri 4;**
- Redaktime materialesh të ndryshme etj.;
- Komunikime dhe takime të ndryshme fizike dhe online me mësues nga diaspora në rastet kur është e nevojshme;
- Rakordimi i gjendjes, hyrje – dalje të ndryshme etj.;
- Përgatitja dhe dizajni i katalogut të botimeve të Qendrës së Botimeve për Diasporën për periudhën 2019–2024.



- Dizajni i kumtesave të pjesëmarrësve në Kuvendin e Punës me temë: “Ruajtja e gjuhës amtare te fëmijët e mërgatës shqiptare”, i mbajtur në Augsburg, Munih të Gjermanisë”, në datat 9-10 mars 2024, si dhe përmbledhja e tyre në një libër elektronik.



► Botime informuese

Në datat 18 – 21 korrik 2024, në Prishtinë, Kosovë, u organizua Seminari XVII mbarëkombëtar për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë “Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë” nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, si dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës.

Për organizimin e këtij Seminari u ngrit Grupi i përbashkët i punës “Për organizimin dhe realizimin e Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, i cili është mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur në Tiranë ndërmjet Ministrisë së



Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, datë 23.03.2015, dhe të bazuar në Urdhrin nr. 180, datë 18.04.2024, i ndryshuar, “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin dhe realizimin e Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, në Urdhrin nr. 241, datë 24.05.2024, “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 180, datë 18.04.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Vendimin nr. 2/847, datë 14.05.2024, “Për emërimin e grupit punues për organizimin e Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës.

Në zbatim të pikës 3 të Urdhrit nr. 180, datë 18.04.2024, “Për ngritjen e Grupit të punës për organizimin dhe realizimin e Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, si dhe të Urdhrit të titullarit të institucionit me nr. 20, datë 2.05.2024, “Për ngritjen e sekretarisë teknike për mbështetjen e grupit të punës gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë dhe në mërgatë”, Qendra e Botimeve për Diasporën, si institucion në varësi të MAS-it, ka kryer funksionin e sekretariatit teknik të këtij grupi.

Për pasqyrimin e plotë të zhvillimit të punimeve në të katër ditët e këtij Seminari mbarëkombëtar, si dhe referuar Vendimit nr. 3, datë 03.07.2024, ku u miratuan detyrat e grupit të punës, Qendrës së Botimeve për Diasporën iu ngarkua detyra e përgatitjes dhe publikimit të përmbajtjes së tij. Në këtë kuadër u përgatit libri me titull: “**Seminari XVII mbarëkombëtar për mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë. Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë**”, materialet e të cilit u redaktuan, u krye dizajni dhe kopertina, si dhe u publikua online në faqen zyrtare të QBD-së.



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

RAPORTI VJETOR

2024

SEKTORI I DIGJITIMIT,
KOMUNIKIMIT DHE
PROJEKTEVE

4. SEKTORI I DIGJITIMIT, KOMUNIKIMIT DHE PROJEKTEVE

4.1. PROJEKTE

► Projekti i BE-së – *Rezidenca e përkthyesve “Fan Noli”*

Gjatë vitit 2024, Qendra e Botimeve për Diasporën realizoi me sukses projektin e rezidencës “Fan Noli”, një iniciativë novatore që synoi promovimin e letërsisë dhe kulturës shqiptare në nivel ndërkombëtar. Ky projekt ishte pjesë e programit “*Culture Moves Europe*”, i financuar nga Bashkimi Evropian, dhe u zhvillua në Tiranë nga 2 shtatori deri më 23 tetor 2024.



Në Rezidencë morën pjesë pesë përkthyes të shquar nga vende të ndryshme të Evropës: Rigels Halili nga Polonia, Eleana Zhako nga Belgjika, Griselda Doka nga Italia, Loreta Schillock nga Gjermania dhe Evelyne Nougues nga Franca. Gjatë rezidencës, ata përkthyen poezi të Dritëro Agollit në pesë gjuhë: anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht dhe greqisht, duke krijuar një **antologji me 60 poezi të përkthyer**. Kjo antologji, e cila është tashmë e aksesueshme dhe e shfletueshme falas në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve për Diasporën, përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërkombëtarizimit të letërsisë shqiptare.

Funded by the European Union




MIMOZA HYSA

Mimoza Hysa është përkthuese e njohur dhe shkrimtare shqiptare. Në vitet e fundit, ajo ka punuar në fushën e studimeve të kulturës dhe letërsisë në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë. Ajo ka punuar për shumë vite në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë. Ajo ka punuar për shumë vite në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë.

Përkthyes
Autore
Studime e letërsisë

Funded by the European Union




MANJOLA NASI

Manjola Nasi është pedagogje, përkthyes dhe autore. Në vitet e fundit, ajo ka punuar në fushën e studimeve të kulturës dhe letërsisë në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë. Ajo ka punuar për shumë vite në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë.

Pedagogje
Përkthyes
Autore

Funded by the European Union




Rigels Halili

Rigels Halili është antropolog kulturor dhe folës në gjuhën shqipe. Në vitet e fundit, ajo ka punuar në fushën e studimeve të kulturës dhe letërsisë në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë. Ajo ka punuar për shumë vite në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë.

Antropolog kulturor
Pedagog
Autore
Përkthyes

Funded by the European Union




ELEANA ZHAKO

Eleana Zhako është diplomuar për Gjuhë shqipe dhe Letërsi në Universitetin e Tiranës dhe për Studime Europiane dhe Ndërkombëtare në Universitetin Pontikon të Athinës. Ajo ka punuar për shumë vite në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë.

Autore
Përkthyes
Publiciste

Funded by the European Union




Griselda Doka

Griselda Doka është lektore dhe autore. Në vitet e fundit, ajo ka punuar në fushën e studimeve të kulturës dhe letërsisë në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë. Ajo ka punuar për shumë vite në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë.

Pedagogje
Autore
Përkthyes

Funded by the European Union




LORETA SCHILLOCK

Loreta Schillok ka lindur në Berat dhe jeton në Gjermani që prej vitit 2001. Ajo ka punuar për shumë vite në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë. Ajo ka punuar për shumë vite në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë.

Lektore
Autore
Përkthyes

Funded by the European Union




EVELYNE NOYGUES

Evelyne Noygues është përkthuese letërsie dhe gjuhësi shqiptare. Në vitet e fundit, ajo ka punuar në fushën e studimeve të kulturës dhe letërsisë në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë. Ajo ka punuar për shumë vite në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Kulturës dhe Letërsisë në Tiranë.

Përkthyes

PËRKTHYES NË LËVIZJE



REZIDENCA E PËRKTHYESVE "FAN NOLI"



Projekti u mbështet nga mentorët dhe përkthyeset, znj. Mimoza Çuliqi dhe znj. Manjola Nasi, të cilat ofruan udhëzime të vyera dhe ekspertizë për përkthyesit gjatë procesit të punës. Ky bashkëpunim i ngushtë i ndihmoi pjesëmarrësit të kuptojnë më thellë thelbin dhe nuancat artistike të veprës së Agollit, duke u dhënë përkthimeve një cilësi të lartë dhe një përkthim autentik të mesazheve poetike.

Përveç punës së përkthimit, rezidenca ofroi një sërë aktivitesh edukative dhe kulturore. Një ndër to ishte punëtorja “Përkthimi i një poezie” në bashkëpunim me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, ku përkthyesit

dhe studentët punuan së bashku për të eksploruar procesin dhe sfidat e përkthimit letrar. Rezidenca gjithashtu përfshiu aktivitete ndërkombëtare, si *Dita Ndërkombëtare e Përkthimit*, ku u diskutuan politika mbështetëse për përkthyesit letrarë dhe rëndësia e promovimit të përkthimeve të letërsisë shqiptare.

Përkthyesit pjesëmarrës morën pjesë gjithashtu në festivalin “Tirana Gate”, ku diskutuan tema që lidhen me përkthimin e poezisë dhe rolin e përkthimit si një urë ndërkulturore. Ky festival ofroi një platformë për shkëmbimin e ideve dhe prezantimin e veprës së Dritëro Agollit si dhe rezidencës.

Ky projekt shërbeu si një urë lidhëse mes kulturës shqiptare dhe asaj ndërkombëtare, duke krijuar një hapësirë të qëndrueshme për dialog kulturor dhe përmirësim profesional për përkthyesit pjesëmarrës. Gjuha shqipe u vendos krahas gjuhëve të tjera falë përkthimit, duke ndërtuar ura ndërmjet gjuhëve dhe kulturave të ndryshme.



► Revista informuese periodike “*Flasim shqip*”

Revista informuese “*Flasim Shqip*”, një projekt i miratuar nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën me vendimin nr. 4, datë 29.06.2023, “*Për miratimin e projektit për përgatitjen e një reviste informuese për shkollat e gjuhës shqipe në diasporë*”, nr. 88 prot., datë 29.06.2023, vijoi botimet e saj periodike këtë vit, duke realizuar tre numra: numrat 2, 3 dhe 4.



Kjo revistë synon të promovojë mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, duke kontribuar në ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar ndër brezat e rinj shqiptarë jashtë atdheut.

Gjatë periudhës janar–prill 2024, Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me kryeredaktoren Yllka Lezo, përgatiti numrin e dytë të revistës, duke vijuar më tej punën me redaktimin, korrektimin dhe dizajnin përfundimtar për ueb. Nga muaji maj, puna u fokusua në numrin e tretë, i cili u përfundua dhe u publikua në gusht 2024. Numri i katërt u përgatit dhe u publikua në uebin e QBD-së në muajin nëntor.

Çdo numër i revistës u pasurua me artikuj që trajtonin tematika të ndryshme mbi ruajtjen e gjuhës, përvojat e mësimdhënies, krijimtarinë e nxënësve dhe aktivitete të ndryshme të shkollave shqipe në diasporë.

Revista “Flasim Shqip” ka shërbyer si një platformë për shkëmbimin e përvojave ndërmjet mësuesve, prindërve dhe nxënësve, duke ndihmuar në integrimin e materialeve edukative dhe kulturore të përshtatura për nevojat e diasporës. Artikujt, krijimet letrare dhe fokusimet tematike kanë ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e gjuhës shqipe dhe kulturës kombëtare, ndërsa përmbajtja është shpërndarë falas në komunitetet shqiptare jashtë vendit.



Gjatë realizimit të revistës, një sfidë mbetet sigurimi i burimeve të qëndrueshme për përgatitjen dhe shpërndarjen e saj, si dhe angazhimi i vazhdueshëm i kontribuesve nga diaspora. Rekomandohet zgjerimi i përfshirjes së mësuesve dhe prindërve në krijimin e përmbajtjeve, si dhe përdorimi më i gjerë i platformave digjitale për shpërndarjen e materialeve.

Revista “Flasim Shqip” është një instrument në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe në diasporë. Me tre botimet e saj gjatë vitit 2024, ajo ka arritur të krijojë një urë lidhëse ndërmjet diasporës dhe atdheut, duke kontribuar në përhapjen e kulturës dhe identitetit shqiptar përmes brezave. Qendra e Botimeve për Diasporën do të vijojë punën me hartimin dhe përgatitjen e kësaj reviste periodike edhe gjatë vitit 2025.

► Shkolla verore “Jam shqiptar”, organizimi i vitit 2024

Bazuar në pikën c, të nenit 9, të Ligjit nr.16, datë 16.04.2018, “Për diasporën”; VKM-në nr. 469, datë 26.07.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, e ndryshuar; masën 34 të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021–2025, e cila ka si indikator realizimin e projektit të Shkollës verore “Jam shqiptar”; marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës me nr. 66/1 prot., datë 18.04.2024, dhe Qendra e Botimeve për Diasporën, me nr. 71 prot., datë 18.04.2024; kërkesën e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, “Kërkesë mbi realizimin e programit të shkollës verore “Jam Shqiptar”, nr. 79 prot., datë 21.05.2024, protokolluar në Qendrën e Botimeve për Diasporën (QBD) me nr. 83 prot., datë 21.05.2024; në objektivin dhe misionin e Qendrës së Botimeve për Diasporën në ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar dhe promovimin e pjesëtarëve të diasporës, si dhe në detyrën e Qendrës së Botimeve për Diasporën për organizimin dhe mbështetjen e veprimtarive dhe projekteve në ndihmë të përhapjes së gjuhës dhe kulturës amtare në diasporë, Qendra e Botimeve për Diasporën nisi bashkëpunimin për organizimin dhe realizimin e projektit të shkollës verore “Jam shqiptar”, për vitin 2024.

Për të përmbushur dhe për të realizuar me sukses projektin e shkollës verore “Jam shqiptar”, për vitin 2024, bazuar në dokumentacionin e sipërcituar, u vendos mes palëve ngritja e një grupi pune. Ky grup pune ka në përbërjen e tij anëtarë nga Agjencia e Kombëtare e Diasporës, Qendra e Botimeve për Diasporën dhe përfaqësues nga Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë në Milano. Grupi i punës ka organizuar vazhdimisht mbledhje me prani fizike dhe online për të koordinuar punën dhe për të siguruar përmbushjen e detyrave të projektit.



Në shkollën verore 2024 morën pjesë nxënës të grupmoshave 13-17 vjeç, që ndjekin shkollat dhe kurset e gjuhës shqipe në Itali, të shoqëruar nga 2 prej mësuesve të tyre. Projekti i këtij viti përfshiu këto shkolla duke qenë se Italia është ndër vendet me numrin më të lartë të shkollave ku mësohet gjuha shqipe dhe kultura shqiptare.

Shkolla verore “*Jam shqiptar*” u zhvillua në Shqipëri për një periudhë 10-ditore, nisi më 21.06.2024 dhe përfundoi më 30.06.2024.

Për hartimin dhe përgatitjen e programit mësimor të shkollës verore, Qendra e Botimeve për Diasporën ka koordinuar punën me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), që, nëpërmjet shkresës së dërguar me nr. 444/1 prot., datë 21.06.2024, me lëndë “*Dërgimi i programit mësimor për projektin: Shkolla verore ‘Jam shqiptar’*”, protokolluar në QBD me nr. 68/1 prot., datë 24.06.2024, na ka përcjellë programin mësimor të përgatitur për shkollën verore.

Programi i përgjithshëm i shkollës verore, i cili u hartua dhe u përgatit nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, synoi të ofrojë një përvojë të pasur për nxënësit pjesëmarrës. Ky program u hartua duke u fokusuar në kombinimin e njohurive gjuhësore, aktiviteteve të ndryshme kulturore, historike, artistike, eksplorimin e traditave, eksplorimin e monumenteve dhe objekteve historike, duke i afruar nxënësit pjesëmarrës me trashëgiminë dhe identitetin e tyre kulturor.

Ashtu siç është përcaktuar në marrëveshjen e përbashkët, Qendra e Botimeve për Diasporën komunikoi dhe koordinoi punën me mësuesit, me lidhjet e shkollave shqipe dhe shoqatat në ndihmë të ruajtjes së mësimin të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në shkollën verore të këtij viti.

Mbështetur në programin mësimor të përgatitur nga ASCAP-i, Qendra e Botimeve për Diasporën organizoi dhe zhvilloi në ambientet e saj orët mësimore “*Ora shqip*” sipas agjendës së përcaktuar për të përmirësuar aftësitë e leximit, shkrimit të gjuhës shqipe tek nxënësit në diasporë. Orët mësimore u përgatitën nga përgjegjësjë e Sektorit të Digjimit, Komunikimit dhe Projekteve, znj. Eva Ismajlukaj, e cila realizoi gjithsej 5 orë mësimore, ku u trajtuan tema të ndryshme, si: historiku i gjuhës shqipe, prezantimi i fjalëve të reja, njohja me qytetet dhe objektet kulturore më të rëndësishme, traditat dhe kulturën shqiptare, si dhe ushtrime praktike në shkrimin e gjuhës shqipe.

Shkolla verore “*Jam shqiptar*” u mbyll me një ceremoni, që u organizua në ambientet e MEPJ-së, ku zëvendësministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Megi Fino, u shpërndau nxënësve certifikatat e pjesëmarrjes.

Në mbyllje të ceremonisë, nxënësit përshëndetën me valle dhe recitime në shqip. Gjatë këtyre vizitave, nxënësit kanë qenë të shoqëruar nga mësuesit e tyre, nga stafi i Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe nga stafi i Qendrës së Botimeve për Diasporën, i cili ka qenë i angazhuar në ndjekjen e veprimtarive dhe zhvillimin e tyre sipas programit.

QBD-ja u shpërndau nxënësve ciklin e botimeve dygjuhëshe “*Tregime të Moçme Shqiptare*” dhe udhërrëfyesit e qyteteve: “*Gjirokastra*”, “*Shkodra*”, “*Prizreni*” etj.



4.2. AKTIVITETE

► *Organizimi i seminarit me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Mynih të Gjermanisë, në datat 9-10 mars 2024*

Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve për Diasporën organizoi Kuvendin e punës me temë: *“Ruajtja e gjuhës amtare te fëmijët e mërgatës shqiptare” në Augsburg, Mynih të Gjermanisë*, në datat 9-10 mars 2024.

Organizimi i këtij kuvendi pune ishte një mundësi shumë e mirë për të bashkuar mësuesit e gjuhës shqipe në diasporë, profesionistët e arsimit, studiuesit dhe përgjegjësit e politikave në një takim të përbashkët.



Në përfundim të kuvendit të gjitha kumtesat u përmbledhën në një libër elektronik, realizimi i të cilit u bë i mundur nga Qendra e Botimeve për Diasporën.

► *Pjesëmarrje në Panairin e librit “Leipzig 2024”, në datat 21-24 mars 2024*

Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në Panairin e librit “Leipzig 2024”, në Lajpcig të Gjermanisë, në stendën e Shqipërisë. Ajo prezantoi dhe shpërndau librat e botuar nga QBD-ja (projektin e saj dygjuhësh shqip-gjermanisht), katalogun e saj të botimeve, si dhe promovoi aktivitetin e Qendrës nëpërmjet materialeve promocionale të përgatitura enkas për këtë panair nga data 21 deri në datë 24 mars 2024.



Më datë 23 mars, në orën 16:00, në stendën e Shqipërisë (Hall 4, stand D403), QBD-ja organizoi takimin me temë: *“Kuteli dhe Agolli në gjermanisht”*, me pjesëmarrëse: **Znj. Andrea Grill**, përkthyesë e librit të Mitrush Kutelit *“Tregime të moçme shqiptare”* nga gjuha shqipe në gjuhën gjermane; **Znj. Loreta Schillock**, përkthyesë e përmbledhjes së poezive të Dritëro Agollit nga gjuha shqipe në gjuhën gjermane, moderuar nga **znj. Mimoza Hysa**.



Gjatë ditëve të panairit u realizua:

- Prezantimi i botimeve dygjuhëshe në standin e Shqipërisë;
- Informimi i vizitorëve të standit;
- Takime dhe biseda në standin me komunitetin shqiptar në Gjermani;
- Takime dhe biseda në standin me të interesuar për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare;
- Promovimi i botimit “Tregime të Moçme Shqiptare”;
- Promovimi i krijimtarisë poetike të Dritëro Agollit;
- Informimi i vizitorëve rreth botimeve të QBD-së dhe punës për realizimin e tyre;
- Shpërndarja e botimeve dygjuhëshe dhe materialeve promocionale të QBD-së;
- Synimi për rritjen e interesit për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare.

Organizimi i trajnimit me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Bolonja të Italisë, më 7 prill 2024

Në vijim të nismës për trajnimin e mësuesve të gjuhës shqipe në diasporë, për të mbështetur ruajtjen e gjuhës shqipe, për të përmirësuar zhvillimin profesional të mësuesve në diasporë dhe për shkëmbimin e përvojave, Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Lidhjen e Shkollave Shqipe në Itali dhe me mbështetjen e ASCAP-it zhvilloi trajnimin njëditor në Bolonja të Italisë, më 7 prill 2024.

Trajnimi u fokusua në mësimdhënien në kushtet e dygjuhësisë. Në aktivitet morën pjesë rreth 90 mësues të gjuhës shqipe në Itali. Për gati dy orë mësuesit e pranishëm ndoqën me shumë interes trajnimin e mbajtur nga znj. Erida Koleci, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, prof. dr. në gjuhësi znj. Linda Mëniku, si dhe autorja e udhërrëfyesve “Jam shqiptar”, znj. Milena Selimi.





Ky trajnim ishte një mundësi shumë e mirë për mësuesit e gjuhës shqipe në diasporë, në mënyrë që të shkëmbejnë përvojat, të ndanin sfidat dhe të mësonin nga njëri-tjetri. Aktivitete të tilla janë jetike për ruajtjen dhe përparimin e gjuhës shqipe në diasporë dhe për të siguruar që brezat e rinj të shqiptarëve të rritur jashtë atdheut të mbeten të lidhur me rrënjët e tyre kulturore dhe gjuhësore.

► ***Pjesëmarrje në Panairin e 3-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor në Tiranë, në datat 23-25 prill 2024***

Panairi, i organizuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Arteve të Kosovës në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit në Shqipëri, synoi që të bëjë të njohura arritjet më cilësore në botimet akademike, shkencore, universitare dhe promovoi figurën e shkencëtarit dhe studiuesit në hapësirën mbarëkombëtare.





Përgjatë 3 ditëve të Panairit, Qendra e Botimeve për Diasporën ishte e pranishme me standin dhe botimet e saj.

Zhvillimi i takimeve online me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë me temë: “Plane dhe projekte për mësimdhënien në diasporë për vitin 2024”



Gjatë vitit 2024, Qendra e Botimeve për Diasporën zhvilloi takime online me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në: Gjermani, Zvicër, Austri, Greqi, Itali, Angli, Suedi, Norvegji e Finlandë, SHBA, Kanada, Francë, Turqi, Belgjikë, Luksemburg, Spanjë, Kroaci, Australi, Danimarkë dhe Ukrainë.

Në këto takime u diskutuan projektet e Qendrës së Botimeve për Diasporën për vitin 2024, me fokus mbështetjen e mësimdhënies në diasporë. Gjithashtu u diskutuan problematikat që hasin mësuesit gjatë procesit të mësimdhënies.



► **Takim në Universitetin “Luigj Gurakuqi”
me temë: “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare në diasporë”, 14 qershor 2024**

Tema “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare në diasporë” ishte në qendër të takimit me znj. Mimoza Hysa, drejtore e Qendrës së Botimeve për Diasporën, të organizuar nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore, departamenti i Letërsisë së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” nën kujdesin e znj. Elinda Dibra, dhe me pjesëmarrjen e znj. Adriana Bejko Fishta, znj. Entela Tabaku, znj. Aurela Konduri dhe znj. Drita Gjongecaj.



Gjatë këtij takimi u trajtuan tematika të rëndësishme që lidhen me politikat shtetërore mbi mësimin e gjuhës shqipe dhe ruajtjen e kulturës shqiptare në diasporë, shkollat shqipe në diasporë, si dhe mbështetjen që Qendra e Botimeve për Diasporën ka ofruar në ndihmesë të procesit të mësimdhënies.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua diskutimeve me mësueset e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, të cilat morën pjesë online. Ato ndanë përvojat e tyre profesionale, duke hedhur dritë mbi sfidat dhe arritjet në mësimdhënien për ruajtjen e identitetit kombëtar në diasporë.

► **Seminari XVII mbarëkombëtar me temë: “Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”, në Prishtinë, në datat 18-21 korrik 2024**

Seminari XVII për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë, me temë “Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”, u mbajt në Prishtinë në datat 18-21 korrik.



Aktiviteti, i organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, shënoi një angazhim të përbashkët për ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kombëtar në diasporë. Në hapje morën pjesë Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, znj. Albërie Nagavci,

dhe zëvendësministrja e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, znj. Nina Guga.

Qendra e Botimeve për Diasporën kishte rolin e sekretarisë teknike të grupit të punës, duke garantuar koordinimin ndërmjet anëtarëve nga të dy ministrinë për realizimin e programit dhe aktiviteteve të seminarit. Punimet u përqendruan te rritja e cilësisë së mësimdhënies përmes metodologjive bashkëkohore dhe përdorimit të teknologjisë.



Ministrja e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, znj. Ogerta Manastirliu, theksoi rëndësinë e përfundimit të teksteve të përbashkëta “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, ndërsa homologia nga Kosova, znj. Arbërie Nagavci, vlerësoi përkushtimin ndaj mësuesve të diasporës.



Seminari përfshiu prezantimin e projekteve si programi “Jam shqiptar”, që fuqizon njohuritë mbi trashëgiminë shqiptare përmes materialeve interaktive, dhe udhërrëfyesin “Prishtina”, i cili u mirëprit si mjet didaktik ndihmës i vlefshëm për mësuesit në diasporë. Diskutimet adresuan edhe



bashkëpunimin mes shkollave dhe mësuesve në diasporë, zhvillimin profesional të tyre dhe përdorimin e materialeve digjitale për të lehtësuar mësimdhënien.

Seminari u mbyll me ndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit, duke shprehur mirënjohje për angazhimin e tyre në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Aktiviteti përforcoi lidhjet ndërmjet diasporës dhe atdheut, duke garantuar vazhdimësinë e identitetit kulturor për brezat e ardhshëm që rriten jashtë vendit.



► ***Pjesë e grupit të punës për organizmin e Kuvendit Kombëtar për Gjuhën Shqipe, në Tiranë, në datat 21-22 nëntor 2024***

Kuvendi Kombëtar për Gjuhën Shqipe, i organizuar në kuadër të Vitit të Gjuhës Shqipe, u zhvillua më 21 dhe 22 nëntor 2024, në Pallatin e Brigadave, duke ofruar një platformë të rëndësishme për diskutime mbi sfidat dhe mundësitë që ka përpara gjuha shqipe në shekullin XXI. Kjo ngjarje e rëndësishme u hap me fjalime përshëndetëse nga figura të larta shtetërore dhe akademike, përfshirë Kryeministrin e Shqipërisë z. Edi Rama, ministrin e Arsimit dhe Sportit znj. Ogerta Manastirliu, Akad. Prof. Dr. Emil Lafe, gjuhëtar, Akad. Prof. Dr. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave, Prof. Dr. Artan Hoxha, Rektor i Universitetit të Tiranës, si dhe znj. Arbërie Nagavci, ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës.

Gjatë punimeve të Kuvendit, u trajtuan çështje thelbësore lidhur me rolin e institucioneve shtetërore dhe akademike në ruajtjen e gjuhës shqipe, ndikimin e teknologjisë dhe globalizimit në përdorimin e saj, si dhe angazhimin e diasporës shqiptare në mësimin e gjuhës amtare dhe ruajtjen e kulturës kombëtare.

Qendra e Botimeve për Diasporën, si pjesë e grupit të punës të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, kontribuoi në organizimin e këtij Kuvendi, duke ofruar mbështetjen e nevojshme për trajtimin e çështjeve të mësimin të gjuhës shqipe në diasporë. Pjesëmarrësit nga Këshilli Koordinues i Diasporës, z. Vaxhid Sejdiu dhe znj. Drita Gjongecaj, përfaqësueset nga Këshilli Koordinues i Arsimtarëve në Diasporë, znj. Aurela Konduri, znj. Miradije Berisha, znj. Teuta Tabaku, si dhe nënkryetarja e Lidhjes së Shkollave Shqipe në Itali, znj. Anila Berberi, kontribuan me diskutime të rëndësishme mbi sfidat e mësimdhënies dhe ruajtjes së gjuhës shqipe në mërgatë, duke propozuar rekomandime për përmirësimin e këtyre proceseve.



Në ditën e dytë të Kuvendit u prezantua rezultati i një punë të madhe të bërë nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë për gjuhën dhe kulturën shqiptare *Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe* me rreth 120 mijë fjalë. Ky Kuvend, i mbështetur nga angazhimi i institucioneve shtetërore dhe akademike, theksoi përkushtimin e palëkundur për zhvillimin dhe ruajtjen e gjuhës shqipe, duke e vendosur atë në një kontekst bashkëkohor dhe global.



► **Organizimi i trajnimit me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Athinë të Greqisë, 15 dhjetor 2024**

Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Greqi, organizoi më datë 15 dhjetor 2024, në Athinë, seminarin trajnues me temë “Metodat e mësimit në kushtet e dygjuhësisë”.

Seminarin e përshëndetën znj. Luella Hajdaraga, ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Greqi; znj. Marina Kaishi, profesore dhe koordinatore akademike e Universitetit “New York College” në Athinë; znj. Mimoza Hysa, drejtoreshë e Qendrës së Botimeve për Diasporën; znj. Klarita Selmanaj, kryetare e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Greqi.

Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Hysa, në fjalën e saj, ndër të tjera, theksoi “rolin e rëndësishëm të QBD-së, e cila në këto pesë vite ka formësuar vetveten duke luajtur një rol të trefishtë: si qendër mbështetëse e mësimit me tekste mësimore dhe materiale plotësuese; si koordinuese mes institucioneve shtetërore shqiptare për politikën e mësimit në diasporë; si organizuese e trajnimeve, seminareve për të rritjen profesionale të mësuesve në diasporë. QBD-ja ka qenë e vazhdon të jetë gjithashtu një qendër mikpritëse dhe e gatshme për zgjidhjen e problemeve të shumta të shkollave shqipe, si dhe promovuese e punës së palodhur të mësimit në diasporë.”



Pas përfundimit të seancave trajnuese dhe seancës së diskutimeve përmbyllëse u shpërndanë certifikata pjesëmarrjeje.



4.3. VEPRIMTARI TË TJERA

Komunikimi

Gjatë kësaj periudhe kemi siguruar një komunikim efektiv, të koordinuar dhe të qëndrueshëm me institucione e individë të interesuar për punën dhe veprimtarinë e QBD-së. Nëpërmjet postës elektronike zyrtare të QBD-së kemi mbajtur lidhje jo vetëm me institucionet me të cilat bashkëpunojmë, por edhe me të gjithë të interesuarit që na kanë kontaktuar.

Menaxhimi i rrjeteve sociale të institucionit

Gjatë vitit 2024 fokusi ynë ka qenë informimi i publikut për aktivitetet e ndryshme të Qendrës së Botimeve për Diasporën. Veprimtaria e QBD-së është pasqyruar në mënyrë të vazhdueshme në rrjetet sociale dhe në faqen e saj të uebit www.qbd.gov.al. Po ashtu janë menaxhaur rrjetet sociale të institucionit: Facebook, Instagram, Twiter, YouTube, LinkedIn.

Përditësimi i portalit

Gjatë vitit 2024 është pasuruar kategoria e librave të shkarkueshëm me udhërrëfyesit që janë përgatitur nga QBD-ja: *Berati, Prishtina, Prizreni dhe Gjakova*, si dhe kategoria e botimeve informuese me 3 numrat e revistes informuese.

Është punuar me mirëmbajtjen e uebit dhe monitorimin e problematikave.

Dizajni dhe digjitimi

Jemi kujdesur për përpunimin dhe vënien në dispozicion për publikun të librave elektronikë (e-book), si dhe materialeve të tjera që janë objekt i punës së QBD-së, duke u kujdesur që çdo libër të jetë i përshtatshëm për lexim në pajisje të ndryshme digjitale.

Është realizuar faqosja e udhërrëfyesve të projektit “*Jam shqiptar*”: *Berati, Prishtina, Prizreni* dhe *Gjakova*, duke përfshirë konceptimin e dizajnit, zgjedhjen e formatit, përgatitjen e stileve, fushën e ngjyrave, dizenjimin, përpunimin e fotove për shtyp dhe për web, faqosjen e çdo libri të kolanës së udhërrëfyesve dhe të kopertinave, përgatitjen e librit në formatin për shtyp dhe hedhjen e korrigjimeve, dhe paketimin në formatin *package* bashkë me të gjitha linket dhe fontet për t’u arkivuar. Janë përgatitur gjithashtu për ueb në formatin librit elektronik e-book.

Është realizuar faqosja e revistës informuese “*Flasim Shqip*”, nr. 2, 3 dhe 4, duke përfshirë hartimin e strukturës dhe dizajnit të brendshëm, duke u fokusuar në krijimin e një përvoje të këndshme dhe funksionale për lexuesit në pajisje digjitale. Të gjitha elementet vizuale, përfshirë fontet, ngjyrat dhe formatimi i tekstit, janë optimizuar për e-book, duke siguruar një paraqitje tërheqëse në çdo ekran.

Është konceptuar dhe përgatitur dizajni i projektit “*Pushime në votër*”, i cili është pasqyruar në rrjetet sociale.

Janë paraqitur grafikisht materiale informuese dhe elemente vizuale për komunikim të brendshëm dhe publik, si dhe për promovimin në rrjetet sociale.

Përditësimi i Programit të Trasparencës

Është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme Programi i Trasparencës dhe është mbajtur komunikim me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën për Informim duke u përcjellë çdo informacion të kërkuar.

4.4. PREZANTIMI DHE PROMOVIMI I PUNËS SË QBD-SË

Raportimi për vitin 2024 për veprimtarinë e Qendrës së Botimeve për Diasporën (QBD) përfshin një gamë të gjerë nismash dhe aktivitete të reja, të cilat kanë pasuruar më tej misionin e saj për ruajtjen dhe promovimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.

Gjatë këtij viti, QBD-ja ka ndërmarrë nismën “**Pushime në Votër**”, një projekt që u dedikohet nxënësve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. Ky program kishte për qëllim të afronte fëmijët me vendlindjen e prindërve të tyre përmes përvojave të drejtpërdrejta. Nxënësit kanë ndarë përshtypjet dhe emocionet e përjetuara gjatë pushimeve të kaluara në Shqipëri përmes letrave të dërguara, duke përshkruar eksperiencat e tyre me pasuri kulturore, tradita dhe peizazhe shqiptare.

Gjithashtu, QBD-ja ka vijuar të pasqyrojë çdo aktivitet të organizuar nga vetë institucioni përmes platformave të saj zyrtare. Publikimet e rubrikave të numrave të **revistës informuese “Flasim shqip”**, si dhe informacionet mbi botimet e reja, janë bërë pjesë e pandashme e komunikimit me publikun. Revista informuese ka shërbyer si një urë për shpërndarjen e të rejave më të fundit rreth mësimdhënies në diasporë, zhvillimeve kulturore dhe botimeve të reja.

QBD-ja ka vazhduar të punojë me përkushtim për të pasqyruar botimet dygjuhëshe në format digjital, duke i vënë ato në dispozicion të shkollave, mësuesve dhe nxënësve në diasporë. Përmes rrjeteve të saj sociale, Qendra ka ofruar përditësime të rregullta mbi aktivitetet, ngjarjet kulturore, ndryshimet legjislative dhe materialeve informuese.

Këto nisma të reja dhe veprimtaritë e vazhdueshme të QBD-së kanë ndihmuar në forcimin e lidhjes me diasporën dhe të gjithë të interesuarit për veprimtarinë e saj, duke i dhënë një dimension të ri angazhimit të saj për vitin 2024.



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

RAPORTI VJETOR

2024

KËSHILLI KOORDINUES
I BOTIMEVE
PËR DIASPORËN

5. KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Bazuar në Vendimin nr. 469, datë 26.07.2018, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, i ndryshuar me Vendimin nr. 75, datë 14.02.2024, të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 469, datë 26.07.2018, të Këshillit të Ministrave ‘Për krijimin organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën’”, ku në pikën 8 të së cilës thuhet shprehimisht se “Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën është organ vendimmarrës për çështjet e botimeve dhe aktiviteteve në diasporë”, ky Këshill ka vijuar veprimtarinë e tij pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën.

Gjatë vitit 2024, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën ka luajtur një rol të rëndësishëm në organizimin e projekteve dhe aktiviteteve të Qendrës me këto vendime:

1. Vendimi nr. 1, datë 07.02.2024, “Për miratimin e organizimit të seminarit me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Mynih të Gjermanisë, me temë: “Ruajtja e gjuhës amtare te fëmijët e mërgatës shqiptare”, në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Diasporës dhe Këshillin Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë, në datat 9 dhe 10 mars 2024, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.
2. Vendimi nr. 2, datë 07.02.2024, “Për miratimin e zhvillimit të trajnimit njëditor me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Itali, më 7 prill 2024, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.
3. Vendimin nr. 3, datë 01.07.2024, “Për miratimin e listës së teksteve mësimore për mësimin plotësues në diasporë për vitin shkollor 2024–2025”.
4. Vendimi nr. 4, datë 04.09.2024, “Për miratimin e sigurimit të pjesshëm të 480 teksteve mësimore/shkolllore për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në SHBA, Kanada, Australi dhe Japoni për vitin shkollor 2024–2025”.



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

RAPORTI VJETOR

2024

KËSHILLI KOORDINUES
I ARSIMTARËVE
NË DIASPORË

6. KËSHILLI KOORDINUES I ARSIMTARËVE NË DIASPORË

Bazuar në Vendimin nr. 469, datë 26.07.2018, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, i ndryshuar me Vendimin nr. 75, datë 14.02.2024, të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 469, datë 26.07.2018, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, ku në pikën 8/1 të së cilës thuhet shprehimisht se “Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë është organ këshillimor për çështjet e mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë”, ky Këshill ka vijuar veprimtarinë e tij pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën.

Gjatë këtij viti, me ndryshimin e bërë në Vendimin nr. 75, datë 14.02.2024, Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë u ristrukturua, duke iu përshtatur dispozitave të reja, dhe tashmë përbëhet nga 10 anëtarë.

Bazuar në Urdhrin nr. 447, datë 26.08.2024, të ministres së Arsimit dhe Sportit, “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve të Diasporës”, anëtarët e emëruar janë 10 (dhjetë).

Pas organizimit të ri, ky Këshill zhvilloi një mbledhje online, më 19 shtator 2024, ku u prezantuan anëtarët e rinj dhe ata të rrizjedhur të KKAD-së, si dhe u diskutuan problematika të fillimit të vitit të ri shkollor 2024–2025 dhe pajisja e tyre me tekste didaktike.

Çdo anëtar paraqiti gjendjen aktuale të klasave dhe kurseve të gjuhës shqipe, përkatësisht sipas shteteve që përfaqësojnë. Ndër të tjera u diskutua edhe rreth aktiviteteve që mund të organizohen, me qëllim ndërgjegjësimin dhe motivimin e prindërve për t’i dërguar fëmijët e tyre që t’i ndjekin këto kurse.

Qendra e Botimeve për Diasporën ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë, duke u kujdesur për krijimin e një hapësire të dedikuar në internet. Në këtë kuadër, u ndërtua një faqe zyrtare në ueb, e cila shërben si platformë informimi, koordinimi dhe komunikimi për anëtarët e Këshillit, si dhe për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. Kjo hapësirë virtuale është konceptuar për të ndihmuar në shpërndarjen e informacioneve, materialeve didaktike, shkëmbimin e përvojave dhe promovimin e aktiviteteve që synojnë ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kombëtar jashtë atdheut.



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

RAPORTI VJETOR

2024

BASHKËPUNIME
ME INSTITUCIONE BRENDA
DHE JASHTË VENDIT

7. BASHKËPUNIME ME INSTITUCIONE BREnda DHE JASHTË VENDIT

7.1. BASHKËPUNIME TË QBD-sË ME INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN DHE DIASPORËN NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË

a) Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore të Përbashkëta për Diasporën

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën (KPMTPD) është ngritur në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës, si dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare”, datë 23.03.2015, e lidhur në Tiranë; Urdhrit nr. 686, datë 15.11.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për caktimin e përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe botimit për diasporën në Komisionin e Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën”, si dhe Vendimit nr. 2-1151, datë 7.07.2020, “Për emërimin e grupit të punës” të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Kosovës.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 23.9.2020, “Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën”, Qendra e Botimeve për Diasporën caktohet në rolin e sekretariatit teknik të këtij Komisioni dhe mbështet punën e tij.

Pas miratimit me Urdhër/Vendimin e Përbashkët, datë 2.02.2023, të tekstit mësimor për diasporën “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli II, si dhe referuar Vendimit nr. 5, datë 22.11. 2023, “Për miratimin e kalendarit të punës për shpalljen e konkursit për tekstet mësimore për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë me titullin “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli III, në janar të këtij viti u shpall thirrja për aplikim në konkursin për tekstet mësimore të nivelit III për diasporën në faqet ueb të dy ministrive të arsimit (Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës).

Në vijim të koordinimit dhe ndjekjes së punës të grupit ndërinstitucional Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve mësimore për diasporën, *Niveli III*, gjatë këtij viti u kalua në këta hapa:

- Koordinimi dhe planifikimi i punës;
- Përgatitja dhe shpallja e konkursit për tekstet mësimore për diasporën në faqet ueb të të dy ministrive përkatëse;
- Organizimi i mbledhjeve të Komisionit të përbashkët, përgatitja e dokumentacionit, zbardhja e procesverbaleve, ndjekja e procesit;
- Shpallja e thirrjes për aplikim të recensentëve;
- Përzgjedhja e listës fituese të recensentëve dhe trajnimi i tyre;
- Propozimi i tekstit mësimor me titull “*Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare*”, *Niveli III, si tekst fitues të konkursit për tekstin mësimor për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë* (me Vendimin nr. 2, datë 27.11.2024, të Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës) me aplikues Shtëpinë Botuese “Albas” në Shqipëri dhe bashkaplikant Shtëpinë Botuese “Dukagjini” në Kosovë, që, sipas kalendarit të punës, pritet që në muajin dhjetor 2024 të miratohet si tekst mësimor fitues nga ministrat përgjegjës për arsimin të të dy vendeve.

b) *Koordinimi dhe ndjekja e punës së grupit ndërinstitucional të punës Shqipëri–Kosovë për organizimin e Seminarit XVII Mbarëkombëtar për mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë*

Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës organizuan në datat 18.07.2024 – 21.07.2024, në Prishtinë, Kosovë, *Seminarin XVII me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë*.

Në zbatim të pikës 3 të Urdhrit nr. 180, datë 18.04.2024, “Për ngritjen e Grupit të punës për organizimin dhe realizimin e Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, si dhe të Urdhrit të titullarit të institucionit me nr. 20, datë 2.05.2024, “Për ngritjen e sekretarisë teknike për mbështetjen e grupit të punës gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë dhe në mërgatë”, Qendra e Botimeve për Diasporën ka kryer funksionin e sekretariatit teknik të këtij grupi.

Në Seminarin e organizuar për herë të XVII, në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, datë 23.03.2015, të lidhur në Tiranë ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, ishin të pranishëm rreth 150 pjesëmarrës: mësues, specialistë, kërkues shkencorë, akademikë dhe studiues nga Austria, Belgjika, Britania e Madhe, Finlanda, Gjermania, Greqia, Italia, Kroacia, Suedia, Norvegjia, Turqia, Zvicra, Danimarka etj., me qëllimin që, përmes ideve, mendimeve, strategjive dhe metodave të ndryshme, të kontribuohet për mësimdhënie cilësore të mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë e mërgatë.

Tema bosht e këtij seminary ishte “*Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë*”.

Qëllimi i organizimit të këtij seminari është aftësimi dhe kualifikimi i mësuesve të mësimin të gjuhës shqipe në diasporë, për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies, duke shkëmbyer edhe përvojat me njëri-tjetrin. Ky seminar u fokusua në trajtimin e metodologjive të mësimdhënies së gjuhës shqipe në aspekt shkencor dhe praktik përmes ligjëratave dhe modeleve të orëve mësimore që u referuan mbështetur edhe në përvojat e ndryshme të mësimdhënësve të gjuhës shqipe në diasporë e të punës që bëjnë me nxënësit ku japin mësim.

Në listën përfundimtare të referuesve në Seminarin XVII, nga 41 aplikime gjithsej, u përzgjedhën 21 referues (prej të cilëve 7 në seancë plenare dhe 14 në punëtori).

Pjesëmarrësit patën mundësi të dëgjojnë ligjërata të ndryshme, të bëhen pjesë aktive e punëtorive dhe aktiviteteve mësimore, si dhe të shkëmbejnë eksperiencat e tyre në drejtim të mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë.

Për organizimin e këtij seminari u angazhua grupi i përbashkët i punës Shqipëri–Kosovë, bazuar në Urdhrin nr. 180, datë 18.04.2024, i ndryshuar, “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin dhe realizimin e Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, me Urdhrin nr. 241, datë 24.05.2024, “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 180, datë 18.04.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Vendimin nr. 2/847, datë 14.05.2024, “Për emërimin e grupit punues për organizimin e Seminarit XVII me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës.

Në mbyllje të Seminarit XVII, Grupi i përbashkët i punës nxori përfundime dhe rekomandime të bazuara në diskutimet e pjesëmarrësve në seminar.

Në funksion të sekretariatit teknik, për të siguruar një bashkëpunim efikas, u punua për:

- Organizimin e takimeve të përbashkëta të grupit punës;
- Organizimin dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e Grupit të përbashkët të punës, përgatitjen e dokumentacionit, zbardhjen e procesverbaleve, ndjekjen e procesit etj.



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN



RAPORTI VJETOR

2024

SEKTORI I FINANCËS
DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE


8. SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

8.1. BUXHETI I AKORDUAR PËR VITIN 2024

Në mbështetje të Ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, shkresës së ardhur nga MAS-i me nr. 806/1 Prot., datë 06.02.2023, “Dërgimin e fondeve të miratuara të shpenzimeve korrente për vitet 2024–2026”, shkresës me nr. 10463/1 Prot., datë 31.07.2024, “Akordim fondi për rritjen e pagave për vitin 2024” si dhe shkresës me nr. 5523/1 Prot., datë 16.09.2024, “Për ndryshime në planin e buxhetit të vitit 2024”, aktualisht për Qendrën e Botimeve për Diasporën janë akorduar fondet si më poshtë:

Totali i shpenzimeve buxhetore të parashikuara është:

Nr.	Emërtimi i llogarive	Viti 2024
1	Paga + sigurime shoqërore (600+601)	23,547,625 lekë
2	Shpenzime Korrente (602)	20,400,000 lekë
3	Investime (230+231)	0 lekë



8.2. BUXHETI I REALIZUAR PËR VITIN 2024

► Shpenzime Korrente (602)

Fondi i shpenzimeve korrente është realizuar me vlerën 19 936 392 lekë ose 97,7% e fondit të planifikuar për vitin 2024. Ky fond zë një pjesë të rëndësishme të realizimit të buxhetit për vitin 2024, pasi janë kryer këto shpenzime:

- Realizimi i blerjes/sigurimit të teksteve shkollore për mësimin plotësues në diasporë për vitin shkollor 2024–2025 *“Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli I dhe II*, tekst mësimor për diasporën i Shtëpisë Botuese “Albas” dhe Shtëpisë Botuese “Dukagjini”, i renditur i pari në listën e fituesve të konkursit për tekstin mësimor për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë për vendet ku ka përqendrim të komunitetit shqiptar në diasporë.
- Realizimi i aktiviteteve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në kuadër të Kuvendit të Gjuhës Shqipe, i mbajtur në nëntor të këtij viti.
- Realizimi i shpenzimeve operative për materiale promocionale, kancelari dhe shpenzime të tjera operative për mirëfunksionimin e aktivitetit të Qendrës së Botimeve për Diasporën.


► Shpenzime për fondin e pagave dhe sigurimeve (600+601)

Qendra e Botimeve për Diasporën ka nisur punë me strukturë të plotë me Urdhrin e Kryeministrit, nr. 76, datë 15.04.2019, dhe menjëherë pas miratimit të Strukturës së saj ka nisur procesin e rekrutimit sipas VKM-së nr. 469, datë 26.07.2019, *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”*, i ndryshuar, sipas Kodit të Punës.

Shpenzimet e realizuara për fondin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore për vitin 2024 janë mbështetur te struktura dhe numri faktik i punonjësve të Qendrës së Botimeve për Diasporën, duke iu referuar Vendimit nr. 421, datë 26.06.2024, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”*, të ndryshuar si dhe Vendimit nr. 422, datë 26.06.2024, *“Për një ndryshim në Vendimin nr. 326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”*, të ndryshuar, si dhe strukturës së re me Urdhrin e Kryeministrit, nr. 220, datë 01.11.2024, *Për një ndryshim në Urdhrin e Kryeministrit, nr. 76, datë 15.04.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën”*.

Konkretisht janë shpenzuar 20 323 160 lekë ose 86.3% e fondit të parashikuar për vitin 2024.

Tabela e buxhetit dhe realizimi për vitin 2024



Përshkrim	AKORDUAR	REALIZUAR	Në %
Shpenzime Korrente (602)	20,400,000.00	19,936,392	97,7%
Shpenzime Kapitale (231)	0	0	0%
Shpenzime Kapitale (231 e drejta e autorit)	0	0	0%
Paga dhe Sigurime 600/601	23,547,625	20,323,160	86,3%
BUXHETI TOTAL 2024	43,947,625	40,259,552	92%

Duke iu referuar tabelës së mësipërme, Qendra e Botimeve për Diasporën ka realizuar **92%** të buxhetit të akorduar prej Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për vitin 2024, duke arritur të realizojë të gjitha projektet e rëndësishme të planit të saj vjetor dhe duke përmbushur misionin e saj.

Menaxhimi i financave

Gjatë vitit 2024, Sektori i Financës dhe Shërbimeve mbështetëse ka evidentuar të gjitha shpenzimet e kryera në përputhje me regjistrin e parashikimeve dhe detajimit të brendshëm të buxhetit të akorduar. Të gjitha shpenzimet (në lekë dhe në valutë) janë pasqyruar në ditarët përkatës, bankë, magazinë dhe arkë. Në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe Udhëzimin për zbatimin e

tij, Sektori i Financës ka përgatitur dhe likuiduar brenda afateve të përcaktuara urdhërshpenzimet për faturat e mara nga realizimi i prokurimeve, pagesat e pagave, honoraret dhe dietat e punonjësve.

Janë përgatitur dhe dërguar për ekzekutim brenda afatit listëpagesat për pagat dhe sigurimet shoqërore, shëndetësore të punonjësve. Raportimet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe rakordimet me Degën e Thesarit janë ekzekutuar brenda afateve të lejuara. Janë likuiduar të gjitha detyrimet tatimore pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë.

Burimet njerëzore

Pas miratimit të strukturës së Qendrës së Botimeve për Diasporën me Urdhrin e Kryeministrit nr. 76, datë 15.04.2019, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën*”, si dhe strukturës së re me Urdhrin e Kryeministrit, nr. 220, datë 01.11.2024, Për një ndryshim në Urdhrin e Kryeministrit, nr. 76, datë 15.04.2019, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën*” si dhe realizimit të procedurave të rekrutimit, Qendra e Botimeve për Diasporën, për vitin 2024, nuk ka pasur ndryshime thelbësore në personel.

Qendra e Botimeve për Diasporën, që prej formimit të saj, ka pasur si filozofi udhëheqëse ngritjen e kapaciteteve solide të burimeve njerëzore dhe të një strukture organike, e cila do të mbështesë me punën e saj për realizimin e misionit dhe objektivave të vazhdueshëm.

Personi përgjegjës për burimet njerëzore disponon dosjet e personelit dhe i menaxhon ato me korrektësi në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

Protokolli

Në bazë të ligjit nr. 9154/2003 “*Për Arkivat*”, është bërë pritja e dokumenteve të hyra në institucion dhe pajisja e tyre me kartelën shoqëruese, numrat e protokollit dhe përcjellja e tyre në sektorët përkatës për ndjekje dhe zbatim. E njëjta procedurë ligjore është ndjekur edhe për shkresat dalëse.

Magazina

Në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, në magazinimin e artikujve është ndjekur dhe zbatuar ligji në fuqi, duke shoqëruar çdo hyrje dhe dalje nga magazina me fletëhyrjen dhe fletëdaljen përkatëse. Brenda muajit dhjetor 2024, Qendra e Botimeve për Diasporën do të përmbyllë edhe procesin e inventarizimit të institucionit.

Prokurimet

Qendra e Botimeve për Diasporën, në përmbushje të misionit të saj dhe duke iu referuar buxhetit të miratuar për vitin 2024, ka hartuar regjistrin e parashikimeve për prokurimet publike. Në zbatim

të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, Qendra e Botimeve për Diasporën, për periudhën janar – dhjetor 2024, ka kryer dhe realizuar me sukses procedurat e prokurimit publik, si: “kancelari”, “blerje tekstesh shkollore për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë”, “printime materiale promocionale, revista dhe broshura”, “shërbim d.d.d. dhe dezinfektim”, “blerje biletash transporti ajror”, “shërbim transport mallrash/udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit”, si dhe prokurime të tjera që i referohen regjistrit të prokurimeve publike të ngarkuar online në faqen zyrtare të APP-së. Në regjistrin e parashikimeve janë ngarkuar në total 11 zëra për prokurim, nga të cilët të gjithë zërat janë realizuar me sukses.



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN



PLANI I PUNËS 2025

PLANI I PUNËS 2025

1. SIGURIMI DHE SHPËRNDARJA E TEKSTEVE SHKOLLORE DHE LITERATURËS PLOTËSUESE PËR VITIN SHKOLLOR 2025–2026

Sigurimi i kërkesave për tekstin e përbashkët “*Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare*”, niveli I, niveli II dhe niveli III, për vitin shkollor 2025–2026, në koordinim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme brenda muajit maj 2025, si dhe plotësimi i kërkesave për literaturë plotësuese.

2. PËRDITËSIMI I TË DHËNAVE TË SHKOLLAVE DHE MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË

Në përmbushje të detyrës së saj, Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes, gjatë vitit 2025, do të vijojë punën me përditësimin e bazës së të dhënave të shkollave dhe mësuesve të gjuhës shqipe në diasporë, të krijuar që në vitin e parë të punës. Të gjitha ndryshimet do të pasqyrohen në hartën digjitale të publikuar në portalin zyrtar të Qendrës së Botimeve për Diasporën.

3. BOTIME

Hartimi dhe përgatitja e revistës informuese “*Flasim shqip*”

Gjatë vitit 2025 do të vazhdojnë botimet periodike të revistës informuese “*Flasim Shqip*”, duke synuar të pasurojmë më tej përmbajtjen dhe formatin, për të përmbushur më mirë nevojat e komuniteteve shqiptare në diasporë.

Qendra e Botimeve për Diasporën planifikon të përfshijë më shumë mësues, prindër dhe nxënës në krijimin e përmbajtjeve, duke promovuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave. Gjithashtu, revista do të fokusohet në përdorimin më të gjerë të platformave digjitale për shpërndarjen e materialeve dhe zgjerimin e audiencës. Parashikohet zgjerimi i tematikave, duke përfshirë artikuj

mbi teknologjinë dhe inovacionin në mësimdhënie, përvoja suksesi nga diaspora dhe aktivitete kulturore që promovojnë identitetin shqiptar.

Botimet do të vijojnë të publikohen në faqen e uebit të QBD-së, duke mbështetur qëllimin kryesor të revistës: ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare ndër brezat e rinj jashtë atdheut.

Projekti “Jam shqiptar”

Do të vazhdojë puna me Projektin “*Jam shqiptar*”, i konceptuar si një cikël me materiale didaktike për mësimdhënien në diasporë, me udhërrëfyes të trashëgimisë kulturore për 10 qytete të Shqipërisë dhe Kosovës, si: Tirana, Durrësi, Shkodra, Berati, Gjirokastra, Kruja, Vlora, Prishtina, Prizreni, Gjakova, për t’u shërbyer fëmijëve të diasporës që të njohin më nga afër Shqipërinë dhe Kosovën, kjo në vijim të programit të librave dygjuhësh.

Projekti është miratuar nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën (KKBD) në mbledhjen e mbajtur më datë 02.09.2022.

Nga ky projekt janë botuar dhe publikuar online në faqen e uebit të QBD-së Udhërrëfyesit: *Shkodra, Berati, Gjirokastra, Prishtina, Prizreni, Gjakova*.

Gjatë vitit 2025 synojmë të përfundojmë projektin me përgatitjen, botimin dhe publikimin online të Udhërrëfyesve: *Tirana, Durrësi, Kruja, Vlora*.

Këta udhërrëfyes do të shoqërohen me ilustrime tërheqëse në vend të përdorimit të fotove, do të jenë tepër të veçantë dhe interesante për grupmoshën që është menduar t’u drejtohen, dhe do t’i njohin ata me bukuritë magjepsëse të Shqipërisë dhe Kosovës. Udhërrëfyesit do të shërbejnë për marrjen e njohurive rreth historisë dhe gjeografisë së qyteteve, trashëgimisë kulturore shqiptare, figurave të shquara, ku fëmijë dhe të rritur do të përfshihen në zbulimin dhe rizbulimin e trashëgimisë kulturore shqiptare.

4. BASHKËPUNIME

Grupi i përbashkët i punës “Për organizimin dhe realizimin e Seminarit XVIII të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë”

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, datë 23.03.2015, e lidhur në Tiranë ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2025 pritet të organizohet *Seminari XVIII për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë*, të organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, për realizimin e të cilit Qendra e Botimeve për Diasporën do të japë kontributin e saj.

5. AKTIVITETE

Takimi mbarëkombëtar “Shqipja në diasporë” (takim dyditor i mësuesve dhe shkrimtarëve)

Për vitin 2025, takimi mbarëkombëtar “*Shqipja në diasporë*” do të vijojë si një nismë e rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe bashkëpunimin mes mësuesve, shkrimtarëve dhe përkthyesve.

Dita e parë do të fokusohet te mësuesit, duke trajtuar praktikatat më të mira në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe sfidat në diasporë, ndërkohë që *dita e dytë* do t’u kushtohet krijuesve letrarë dhe përkthyesve, duke nxjerrë në pah rëndësinë e letërsisë dhe përkthimit në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor shqiptar.

Synohet që aktiviteti të zgjerohet me më shumë pjesëmarrës ndërkombëtarë, të trajtojë tema të reja dhe të nxisë përfshirjen e komuniteteve shqiptare nga e gjithë bota, duke kontribuar në këtë mënyrë në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës dhe kulturës sonë kombëtare.

Trajnime dhe seminare për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë

Përgjatë vitit 2025, Qendra e Botimeve për Diasporën do të vijojë organizimin e trajnimeve dhe seminareve për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, duke kombinuar formatin virtual dhe atë me prani fizike. Aktivitetet do të fokusohen në mbështetjen e mësuesve për përdorimin e niveleve I, II dhe III të tekstit mësimor “*Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare*”, si dhe të *Udhëzuesit për zhvillimin e mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare*.

Po ashtu, në kuadër të programit “*Mësues për Greqinë*”, do të organizohen trajtimit të veçanta për të adresuar nevojat specifike të mësimdhënies në këtë vend.

Seminaret dhe trajnimet do të zhvillohen në shtete me prani të madhe të shqiptarëve, si: Italia, Gjermania, Anglia, Zvicra dhe Greqia, duke ofruar një mbështetje të plotë dhe të specializuar për mësuesit dhe komunitetet shqiptare.

Takime online me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë

Qendra e Botimeve për Diasporën parashikon të organizojë mbledhje online me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. Këto takime do të krijojnë një hapësirë të vlefshme për bashkëpunim, shkëmbim përvojash dhe përmirësim të vazhdueshëm të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në komunitetet jashtë atdheut.

Organizimi i shkollës verore për fëmijët e diasporës

Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, parashikon organizimin e shkollës verore për fëmijët e diasporës shqiptare.

Ky projekt do të ofrojë për të tretin vit radhazi një përvojë edukative dhe kulturore, duke i ndihmuar fëmijët të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në gjuhën shqipe, si dhe të thellojnë lidhjen me kulturën, traditat dhe historinë shqiptare. Shkolla verore synon gjithashtu të forcojë bashkëpunimin me shkollat shqipe në diasporë dhe të krijojë një hapësirë për ndërveprim dhe shkëmbim përvojë mes pjesëmarrësve.

Pjesëmarrja e QBD-së në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare

Qendra e Botimeve për Diasporën do të synojë praninë e saj në panairët kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim vendosjen e kontakteve dhe përditësimin me botimet më të mira në fushën e mësimdhënies apo të letërsisë për fëmijë.

Mbështetje dhe bashkorganizime me komunitetet shqiptare në diasporë

Mbështetja e organizimeve të aktiviteteve, seminareve, festivaleve kulturore apo letrare që kanë në fokus gjuhën dhe letërsinë shqipe nga shoqatat dhe lidhjet e mësuesve në diasporë.




QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN



SHTOJCA

VENDIME TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT TË SHQIPËRSË DHE KOSOVËS

VENDIME TË KËSHILLIT KOORDINUES TË BOTIMEVE PËR DIASPORËN



**KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE I KOSOVËS
PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN**

VENDIM

Nr. 1, datë 22.10, 2024

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË RECENSENTËVE PËR VLERËSIMIN
E TEKSTIT MËSIMOR PËR MËSIMIN PLOTËSUES TË GJUHËS SHQIPE
DHE KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË DHE NË MËRGATË**

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për diasporën (në vijim Komisioni i Përbashkët), i krijuar në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, datë 23.03.2015, e lidhur në Tiranë, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, bazuar në Vendimin nr. 756, datë 23.09.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën”, Vendimin nr. 2-1151, datë 7.07.2020, “Për emërimin e grupit të punës”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, Urdhrin nr. 686, datë 15.11.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për caktimin e përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe botimit për diasporën në Komisionin e Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore të Përbashkëta për Diasporën” dhe Urdhrin/Vendimin e Përbashkët, nr. 21, datë 13.01.2023, “Për miratimin e paketës së dokumenteve për procedurën e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe niveli III”.

Faqe 1 nga 3

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së recensentëve për vlerësimin e tekstit mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë, me titull “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli III, sipas renditjes më poshtë:

- **Specialist/ekspert, Gjuhë shqipe:**

1. Shkëlqim Millaku
2. Rozana Rushiti
3. Shemsi Hazir
4. Sejdi Gashi
5. Albana Deda
6. Natasha Kozmaj
7. Brikena Smajli

- **Specialist/ekspert, Letërsi shqipe:**

1. Anila Mullahi
2. Ermelinda Kashah
3. Vesel Islami
4. Xhevahire Topanica
5. Viola Isufaj

- **Specialist/ekspert i redaktimit gjuhësor:**

1. Anrila Spahija
2. Zija Kurti

- **Specialist/ekspert, Gjeografi:**

1. Jostina Dhimitri
2. Addhe Krasniqi

- **Specialist/ekspert, Histori:**

1. Kosovare Rahimi
2. Najada Hoxha

Faqe 2 nga 3

- **Specialist/ekspert, Kulturë figurative:**

1. Silvana Nini

- **Specialist/ekspert, Kulturë muzikore:**

1. Majlinda Hala

- **Mësues nga diaspora:**

1. Anila Kadija

2. Nora Abedini Gashi

3. Vaxhid Sejdiu

4. Jerida Kulla

KOMISIONI I PËRBASHKËT

Znj. Anila Ferizaj

Z. Arbër Salihu

Znj. Mimoza Hysa Çuliqi

Znj. Erida Koleci

Znj. Ardjana Gjini

Znj. Shqipe Gashi-Ramadani

Z. Isni Kryeziu

Znj. Feime Llapashtica Lipesomb

Znj. Evis Mastori



**KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE I KOSOVËS
PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN**

VENDIM

Nr. 2, datë 27.11. 2024

PËR

**PROPOZIMIN E TEKSTIT MËSIMOR ME TITULL “GJUHA SHQIPE
DHE KULTURA SHQIPTARE”, NIVELI III, SI TEKST FITUES TË KONKURISIT
PËR TEKSTIN MËSIMOR PËR MËSIMIN PLOTËSUES NË DIASPORË
DHE NË MËRGATË**

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën (në vijim Komisioni i Përbashkët), i krijuar bazuar në Vendimin nr. 756, datë 23.09.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën”, Vendimin nr. 2-1151, datë 7.07.2020, “Për emërimin e grupit të punës”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, Urdhrin nr. 686, datë 15.11.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për caktimin e përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe botimit për diasporën në Komisionin e Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore të Përbashkëta për Diasporën” dhe Urdhrin/Vendimin e Përbashkët, nr. 21, datë 13.01.2023, “Për miratimin e paketës së dokumenteve për procedurën e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe niveli III”.

Faqe 1 nga 2

VENDOSI:

Tu propozojë ministrave përgjegjës për arsimin të të dyja vendeve tekstin mësimor me titull “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli III, të përgatitur nga shtëpia botuese “Albas” në partneritet me shtëpinë botuese “Dukagjini”, si tekst fitues të konkursit për tekstin mësimor për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë, niveli III.

KOMISIONI I PËRBASHKËT

Znj. Anila Ferizaj

Z. Arbër Salihi

Znj. Feime Llapashtica Lipsomb

Znj. Erida Koleci

Znj. Ardjana Gjini

Znj. Shqipe Gashi-Ramadani

Z. Isni Kryeziu

Znj. Mimoza Hysa Çuliqi

Znj. Evis Mastori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 30 Prot.

Tiranë, më 07.02 2024

VENDIM

KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 1 datë 07.02 2024

“Për

Miratimin e organizimit të seminarit me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Mynih të Gjermanisë, me temë: “*Ruajtja e gjuhës amtare te fëmijët e mërgatës shqiptare*”, në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Diasporës dhe Këshillin Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë, në datat 9 dhe 10 mars 2024”

Në mbështetje të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “*Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*”, VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”, e ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 443, datë 26.06.2019, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën:

VENDOSI:

1. Miratimin e organizimit të seminarit me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Mynih të Gjermanisë, me temë: “*Ruajtja e gjuhës amtare te fëmijët e mërgatës shqiptare*”, në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Diasporës dhe Këshillin Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë, në datat 9 dhe 10 mars 2024, në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas projektit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

VOLTISA BLETA (KOÇI)

Auëtatë:

Znj. Anila Ferizaj

Znj. Enkeleda Riza

Z. Stefan Çapaliku

Znj. Brunilda Spahiu

Adresa: Rruga “*Vilat Gjermane*”, Vila Nr.6, Tiranë, Shqipëri
info@qbd.gov.al, www.qbd.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 31 Prot.

Tiranë, më 07.022024

VENDIM

KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 2 datë 07.022024

“Për

Miratimin e organizimit të trajnimit njëditor me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Itali, më 7 prill 2024.”

Në mbështetje të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, e ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 443, datë 26.06.2019, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën:

VENDOSI:

1. Miratimin e zhvillimit të trajnimit njëditor me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Itali, më 7 prill 2024, në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas projektit bashkëlidhur.
 2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

VOLTISA BLETA (KOÇI)

Anëtarë:

Znj. Anila Ferizaj

Znj. Enkeleda Riza

Z. Stefan Çapaliku

Znj. Brunilda Spahiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 100 prot.

Tiranë, më 01.07 2024

VENDIM

KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 3 datë 01.07 2024

Për

*Miratimin e listës së teksteve mësimore për mësimin plotësues në diasporë
për vitin shkollor 2024-2025*

Në mbështetje të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën", i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 443, datë 26.06.2019, "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë", shkresës së ardhur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit "Kthim përgjigje", nr. 3324/1 prot., datë 18.06.2024, protokolluar me tonën me nr.80/1, datë 21.06.2024, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën:

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së teksteve mësimore për mësimin plotësues në Diasporë për vitin shkollor 2024-2025, sipas aneksit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

VOLTISA BLETA (KOÇI)

Anëtarë

Znj. Anila Ferizaj

Znj. Enkeleda Riza

Znj. Evalda Paci

Znj. Brunilda Spahiu

Kërkesat për tekste shkollore nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH për vitin shkollor 2024-2025					
Nr.	Përfaqësia	“Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli 1	“Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli 2	Destinacioni	Komente
ITALI					
1	Ambasada Romë	230	70	Embassy of the Republic of Albania Via Asmara 5, 00199 Roma, ITALIA	
2	Konsullata Milano	250	250	Consolato Generale di Albania Via San Martino 10-20122 Milano, ITALIA	
3	Konsullata Bari	-	50	Consolato Generale di Albania Corso Vittorio Emanuele 171, 70122 Bari, ITALIA	
GREQI					
4	Ambasada Athinë	390	320	Embassy of the Republic of Albania Vekiareli 7 Filothei 15237, Athens, GREECE	
5	Konsullata Selanik	90	135	General Consulate of Albania Tsimiski 43, TK 54623 Thesaloniki, GREECE	
GJERMANI					
6	Ambasada	100	300	Embassy of the Republic of Albania Friedrich str. 231, 10 969 Berlin,	

	Berlin			GERMANY	
7	Konsullata Mynih	250	350		
ZVICËR					
8	Ambasada Bernë	190	330	Embassy of the Republic of Albania Pourtallesstrasse 45 A, CH-3074 Muri bei, Bern, SËITZERLAND	
TURQI					
9	Ambasada Ankara	110	110	Embassy of the Republic of Albania İlkbahar Mahallesi, Medeni Müdafî Sokak, No 35, Çankaya, Ankara, TURKEY	
AUSTRI					
10	Ambasada Viene	30	40	Embassy of the Republic of Albania in the Republic of Austria. Prinz Eugen Str. 18/1/5; A-1040 Eïen.	
11	Ambasada Bukuresht	15	5		
JAPONI					
DANIMARKË					
12	Ambasada Kopenhagë	120	0	Embassy of the Republic of Albania Frederiksholms Kanal 4, st.tv 1220 Copenhagen K. DENMARK	
SLLOVENI					

13	Ambasada Lubjanë	80	80	-- -- -- -- --
IZRAEL				
14	Ambasada Tel Aviv	60	0	
BRITANI E MADHE				
15	Ambasada Londer	250	250	
KROACI				
16	Ambasada Zagreb	45	30	
BELGJIKE				
17	Ambasada Bruksel	50	50	
SUEDI				
18	Ambasada Stokholm	0	150	

TOTALI 2260 (niveli I) 2520 (Niveli II)

GJITHSEJ 4780 (Niveli I + Niveli II)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 133 prot.

Tiranë, më 04.09. 2024

VENDIM

KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 4 datë 04.09 2024

Për

miratimin e sigurimit të pjesshëm të 480 teksteve mësimore/shkollore për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në SHBA, Kanada, Australi dhe Japoni për vitin shkollor 2024-2025

Në mbështetje të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, vendimit nr. 469, datë 26.07.2018, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën", i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 443, datë 26.06.2019, të Këshillit të Ministrave "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë", shkresës së ardhur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit "Kthim përgjigje", nr. 3324/1 prot., datë 18.06.2024, protokolluar pranë Qendrës së Botimeve të Diasporës me nr.80/1, datë 21.06.2024, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën,

VENDOSI:

1. Miratimin e sigurimit të pjesshëm të 480 teksteve mësimore/shkollore për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë për vitin shkollor 2024-2025, përkatësisht në: SHBA 350 tekste (Niveli I), Kanada 55 tekste (Niveli II), Australi 65 tekste (Niveli I) dhe Japoni 10 tekste (Niveli I), bazuar në kërkesat e misioneve diplomatike të Republikës së Shqipërisë në këto shtete, të dërguar zyrtarisht në Qendrën e Botimeve të Diasporës (QBD) me shkresën nr. 7781 prot., datë 17.05.2024 nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe në shkresën nr. 3324/1 prot., datë 18.06.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ku përcaktohet se përgatitja e teksteve shkollore për diasporën duhet të bëhet me fonde buxhetore të miratuara për QBD për vitin 2024, në bazë dhe për zbatim të legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

VOLTISA BLETA (KOÇI)

Anëtarë:

Znj. Anila Ferizaj

Znj. Enkeleda Riza

Znj. Evalda Paci

Znj. Brunilda Spahiu

